

V E N D I M
Nr.457, datë 23.9.1999

**PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIT TË KËRKESËS PËR SHPRONËSIMIN E BANESËS SË
NAZMI TOMËS NË ORENJË TË LIBRAZHBIT, PËR INTERESA PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë të paluejtshme”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

1. Miratimin e publikimit të kërkesës për shpronësimin e banesës së Nazmi Tomës në Orenjë të Librazhdit, e cila është monument kulture me vlera historike, arkitekturore dhe muzeore.
 2. Shpenzimet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 1999, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Bashkia e Qytetit të Librazhdit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko